



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

V E N D I M

Nr. 63 datë 30.04 2026

**“PËR NDRYSHIMIN E VKB NR. 15 DATE 29.01.2026 “ PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT TË
“STIMULIMI I INDUSTRIVE KREATIVE” DHE PËRZGJEDHJEN E PARTNERIT PËR
ZBATIMIN E KËTIJ PROJEKTI NË QYTETIN E KORÇËS”**

Drejtorja e Financës, Buxhetit dhe MFK; Drejtorja e Përgjithshme Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Drejtorja e Turizmit, Projekteve të Zhvillimit, bazuar në nenin 25 të ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar referuar nenit 54 «Detyrat dhe kompetencat e Këshillit bashkiak» VKB NR. 139 datë 26.12.2025 “ Për projekt buxhetin e Bashkisë Korçë i vitit 2026 dhe PBA 2026- 2028” ligjit Nr. 70/2016 “Për Zejtarinë në Republikën e Shqipërisë”, ligjit Nr. Nr. 43/2022 “Për Zhvillimin e ndërrmarjeve mikro, të vogla dhe të mesme” , VKB nr. 15 datë 29.01.2026 “Për miratimin e projektit “Stimulimi i Industrive Kreative” dhe përzgjedhjen e partnerit për zbatimin e këtij projekti në qytetin e Korçës” dhe mbas diskutimeve të këshilltarëve,

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I

1. Të miratojë ndryshimin e VKB nr. 15 datë 29.01.2026 “Për miratimin e projektit “Stimulimi i Industrive Kreative” dhe përzgjedhjen e partnerit për zbatimin e këtij projekti në qytetin e Korçës” në pikën 4 të tij.
2. Pika 4 e Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 15 datë 29.01.2026 do të bëhet si më poshtë:
Kontratat e qirasë për zhvillimin e aktivitetit të artizanëve dhe prodhuesve kreative lokale do të lidhen për një periudhë 3 (tre) vjeçare.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtorja e Financës, Buxhetit dhe MFK; Drejtorja e Përgjithshme Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore si dhe Drejtorja e Turizmit, Projekteve të Zhvillimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva NAÇI

Miratuar me 22 vota

Vota Pro 22

Vota Kundër 0

Vota Abstenim 4

Zbardhur më datë 30-04-2026

